| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti i Edukimit** |
| **Titulli i lëndës:** | **Filozofi e edukimit** |
| **Niveli:** | **MA** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative** |
| **Viti i studimeve:** | **II** |
| **Numri i orëve në javë:** | **3** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **5** |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. Ass. Dr. Sc. Jehona Ferizi Miftari** |
| **Detajet kontaktuese:** | **Fakulteti i Edukimit, K i IV-të, Z 16**<br>**jehona.ferizi-miftari@uni-pr.edu** |
| **Koha / lokacioni:** | Vendi: Fakulteti i Edukimit - Prishtinë |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | *Në pjesën e parë të kursit ofohen përmbajtje thelbësore për historikun e edukatës, filozofinë esencialiste dhe ekzistencialiste, filozofinë progresiviste dhe pragmatiste, konstruktivizmin si dhe rrymat e tjera filozofike që formësojnë bazën e funksionimit të arsimit. Në pjesën e dytë ofrohen përmbajtje për rëndësinë e edukimit në formimin e individit dhe të shoqërisë për misionin dhe tiparet e mësuesit të shkollës bashkëkohore, rolin e shkollës dhe mësimdhënësit në të kaluarën dhe sot. Në kurs poashtu do të diskutohet edhe për efektin e globalizimit në edukim.* |
| **Qëllimet e lëndës:** | *Qëllimi i kursit është që studentët të identifikojnë, analizojnë problemet teorike të pedagogjisë, te reflektojnë për procesin dhe problemet aktuale të edukimit, të reflektojnë për rrymat filozofike, për përparësitë dhe mangësitë e tyre, duke përfituar kështu njohuri për edukatën si kategori shoqërore, për ndryshueshmërinë e individit si pasojë e të nxënit, për cështjet e përgjithshme të filozofisë së edukimit dhe të arsimit.* |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | *Studentët do të:*<br>*NJOHURITË*<br>• *shpjegojnë nocionet themelore pedagogjike në kontekst të ndryshimeve dhe zbulimeve të reja në fushën e edukatës, arsimit e mësimit;*<br>• *reflektojnë për konceptet bazike të filozofisë së edukimit;*<br>• *analizojnë rrymat/drejtimet më kryesore filozofike dhe ndikimin e tyre në fushën e edukimit;*<br>• *analizojnë parimet e edukimit demokratik, kulturën dhe vlerat e demokracisë;*<br>• *argumentojnë rëndësinë e edukatës, arsimit, e mësimit si kategori themelore pedagogjike, duke reflektuar për fuqinë dhe kufijtë e tyre në jetën e qytetarit në shoqërinë demokratike;*<br>• *krahasojnë rolin e shkollës dhe mësimdhënesit në të kaluarën dhe sot*<br>• *gjykojne per nevojen e tejkalimit te qasjeve, pikepamjeve, praktikave te vjetëruara të edukimit;*<br>*SHKATHTËSITË*<br>• *Zbatojnë në mënyrë të pavarur njohuritë, shkathtësitë e shprehitë e fituara në kuadër të lëndës;*<br>• *Hulumtojnë shumëllojshmëri materialesh dhe burimesh mësimore.*<br>*VLERAT*<br>• *gjykojnë për rëndësinë e freskimit të diturive dhe shtimit të kompetencës profesionale në veprimtarinë arsimore e edukative në kohën e zhvillimeve të vrullshme në mileniumin e tretë;*<br>• *Respektojnë idetë e të tjerëve;*<br>• *Kryejnë të gjitha obligimet me profesionailizëm, përkushtim, integritet dhe kompetencë.* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| **Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 3 | 15/javë | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | / | / | / |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 1 | 1 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 5 | 10 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 10 | 20 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 1 | 1 | 1 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 1 | 3 | 3 |

<table>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Totali</td><td></td><td></td><td>125</td></tr>
<tr><td>Metodologjia e mësimdhënies:</td><td colspan="3">Ligjerata, diskutime, punë në grupe, punë në cifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies, shkrim reflektiv, punë me projekte.</td></tr>
<tr><td>Metodat e vlerësimit:</td><td colspan="3">
<table>
<tr><td>Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim</td><td>10 %</td></tr>
<tr><td>Angazhimet / detyrat ne Classroom</td><td>15 %</td></tr>
<tr><td>Puna me projekte</td><td>25 %</td></tr>
<tr><td>Test / provim</td><td>50 %</td></tr>
</table>
<table>
<tr><th>Nota</th><th>5</th><th>6</th><th>7</th><th>8</th><th>9</th><th>10</th></tr>
<tr><td>Përqindjet</td><td>Deri 50%</td><td>51-60%</td><td>61-70%</td><td>71-80%</td><td>81-90%</td><td>91-100%</td></tr>
</table>
</td></tr>
<tr><td colspan="4">Literatura</td></tr>
<tr><td>Literatura bazë:</td><td colspan="3">
<ul>
<li>Haynes, J., Gale, K., & Parker, M. (2014). Philosophy and Education: An introduction to key questions and themes. Routledge.</li>
<li>Smeyers, P. (Ed.). (2018). International Handbook of Philosophy of Education.</li>
<li>Allan, C., Orstein, F., & Hunkins, P. (2003). Kurikulat, bazat, parimet dhe problemet. Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike.</li>
<li>Bailey, R. (2010).The philosophy of education. An Introduction. London: Continuum International Publishing Group</li>
</ul>
</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | • Grup autorësh (2002). Pedagogët e mëdhenj, Tiranë |
| **Literatura shtesë:** | • Arends. R. (1998). Learning to Teach. Mc Graw Hill<br>• Djui, Xh. (2003). Shkolla dhe shoqëria, Tiranë<br>• Oakes, J. Lipton, M.(2008). Teaching to change the world.<br>• Jalongo, R. Isenberg, J. (1995). Teachers' stories. JOSSEY-BAS<br>• Kraja, M. (2009). Pedagogjia. Tiranë: Mirgeeralb.<br>• Grup autorësh. (2005). Mësimdhënia me në qendër nxënësin. Tiranë: QTK<br>• Koliqi, H. (2005). Histori e pedagogjisë botërore, I & II. Prishtinë: Libri Shkollor |

| Plani i dizejnuar i mësimit: | |
|---|---|
| **Java** | **Ligjerata që do të zhvillohet** |
| *Java e parë:* | Njoftim me programin, obligimet, procesin e vlerësimit, literaturën, metodologjinë e mësimdhënies dhe propozime eventuale. |
| *Java e dytë:* | Nocioni edukatë në kuptimin e gjërë dhe të ngushtë<br>Rëndesia e edukatës dhe arsimit për individin dhe për shoqërinë |
| *Java e tretë:* | Edukimi, njeriu dhe shoqëria<br>Funksionet dhe determinantet historike të edukatës |
| *Java e katërt:* | Filozofia e edukatës dhe fillet e saj. Kuptimi, rëndësia dhe aktualiteti |
| *Java e pestë:* | Pasqyra zhvillimore e mendimit didaktik |
| *Java e gjashtë:* | Prezentimet e punës së studentëve në projektin *Fletepalosja/ Pedagogët e mëdhenj* |
| *Java e shtatë:* | Vështrim i përgjithshëm i filozofive kryesore/ Idealizmi; Realizmi |
| *Java e tetë:* | Vështrim i përgjithshëm i filozofive kryesore/ Pragmatizmi; Ekzistencializmi |
| *Java e nëntë:* | Filozofitë mbi arsimin dhe edukimin: Perenializmi dhe Esencializmi |

| | |
|---|---|
| *Java e dhjetë:* | Filozofitë mbi arsimin dhe edukimin/ Progresivizmi dhe Rikonstruksionizmi |
| *Java e njëmbëdhjetë:* | Prezentimet e punës së studentëve në projektin *filozofitë arsimore dhe teoritë e të nxënit në kuadër të tyre* |
| *Java e dymbëdhjetë:* | Efektet e Globalizimit ne arsim (globalizimi si dukuri e kohës së sotme, fusha e globalizimit dhe dukuritë që e mbështesin) |
| *Java e trembëdhjetë:* | Funksioni edukativo-arsimor i shkollës (funksionet dhe qëllimet e saj) /<br>Vështrim kronologjik / "Shkolla e vjetër" dhe "Shkolla e re" |
| *Java e katërmbëdhjetë:* | Filozofia personale e mësimdhënësit<br>Rolet e shumëfishta të mësimdhënësit sot |
| *Java e pesëmbëdhjetë:* | Analizë e programit, sygjerime për provim |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| - Secili student ka të drejtë të bëjë pyetje e komente sa herë që i jepet fjala;<br>- Asnjëri nuk ka të drejtë t'i ndërhyjë tjetrit kur ai e ka fjalën;<br>- Lejohet "zhurma" e punës kur studentët punojnë në grupe;<br>- Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjërohet nga mësimdhënësi apo prezentohet puna e studentëve;<br>- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme<br>- Dënohet cdo formë e kopjimit apo falsifikimit |
| **Përgjegjësitë e vijuesve të kursit** |

-Të sigurojnë literaturën e rekomanduar për lëndën.

-Të përgatiten rregullisht për pjesëmarrje aktive në ligjërata dhe ushtrime.

-Të respektojnë idetë e të tjerëve.

-Të përmbushin detyrimet e kursit në afatet e caktuara.

**Përgjegjësitë e mësimdhënësit**

-Të prezantojë rregullisht në ligjërata ose në raste të jashtëzakonshme kur mungon, të informojë paraprakisht vijuesit për mungesën dhe kohen e kompensimit të orëve.

-Të udhëheqë dhe moderojë me efikasitet debatet, prezantimet dhe diskutimet për përmbajtje të temave të kursit.

-Të monitorojë dhe vlerësojë angazhimin dhe rezultatet e secilit vijues të kursit.

-Të mbajë portfolion e angazhimit të vijuesve.

-Të përgatisë instrumente të vlerësimit përfundimtar.